



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

REAGIM PUBLIK

Konstatimet dhe sulmet verbale qëllimkeqe në publik, nuk janë të pakta që bëhen nga persona të ndryshëm e me funksione të ndryshme. Kur ato bëhen nga personat laik dhe që nuk kanë njohuri për natyrën e punës sakrifikuase të mjekëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësor, nuk është e arsyetuar, por padituria është rrethanë lehtësuese. Mirëpo kur sulmet e tilla verbale vijnë nga personat që mëtojnë të jenë përfaqësues të popullit dhe e promovojnë veten si profesionist shëndetësor, është rrethanë rënduese.

Deklarimet e deputetës, znj. Albena Reshitaj, të bëra me datë 27 korrik 2021, në Komisionin Parlamentar për Infrastruktur dhe të transmetuara nga mediat, e cila lidhur me aksidentin e ndodhur në Kroaci në të cilin kanë pësuar mërgimtarët tonë, thotë se ka qenë fat në fatkeqësi që tragjedia ka ndodhur në Kroaci e jo në Kosovë, pasi që sipas saj do të kishte dyfish më shumë viktima. Është për tu çuditur se si deputetja Reshitaj ka gjetur insipirim që të gjej fatmirësi në një fatkeqësi të tillë në kurrizë të profesionistëve shëndetësor dhe sistemit shëndetësor sado i brishtë të jetë ai. Respektin më të madh për kolegët tonë kroat, por dëshërojmë ta përkujtojmë deputeten se janë po këta mjekë e profesionistë të tjerë shëndetësor që janë ballafaquar në mënyrë të shkëlqyeshme me pasojat e ngjarjeve të marsit 2004, të helmimit të mbi 40 ushtarëve të UÇPMB, tërmeti i Gjilanit, eksplozimi në Ferizaj, së fundmi me pandeminë COVID-19 në kushte minimale të punës, ballafaqimin me rastin e helmimit masiv në Komunën e Deçanit dhe shumë raste të tjera në të kaluarën, në të cilat jo vetëm se është treguar profesionalizmi i profesionistëve shëndetësor, por mbi të gjitha vullneti dhe forca humane e mbivërtetuar deri më tani. Në gjitha këto ngjarje në pararojë qëndronte shërbim jonë emergjent!

Oda e Mjekëve të Kosovës dënon ashpër denigrimin pandemik të profesionistëve shëndetësor që bëhet në publik në mënyrë të vazhdueshme, sidomos kur këto sulme verbale janë të drejtuara nga persona që janë të mëveshur me funksione publike. Është e paarsyeshme dhe e patolerueshme që stigmatizimi në barrë të profesionistëve shëndetësor të bëhet mjet për të përmbushur zbrastësitrat e tematikave reale lidhur me problemet në shoqërinë tonë.

PRISHTINË, 28 korrik 2021

